

Pierre de Coubertin-Themeluesi i lojrave olimpike

IDEJA

Që prej rilindjes në shumë vende të Europës u bënë përpjekje për të rigjallëruar edhe një herë lojrat olimpike antike. Një hov i dhanë dhe gërmimet gjermane në Olimpin antik në vitet 1875-81. Shembuj të shumtë greke, udhëtimet e shumta në Britani dhe amerikë zgjuan tek Pierre Coumbertin idenë e rilindjes së lojrave olimpike. Një ndikim të madh në këtë ide ushtroi dhe Dr. William Penny Brooke- mjek në një qytezë angleze Much Wenlock) i cili në vitin 1850 organizoi lojrat olimpike në Wenlock, lojra olimpike të rangut rajonal.

Një ndikim të madh në këtë ide ushtroi dhe Dr. William Penny Brooke- mjek në një qytezë angleze Much Wenlock) i cili në vitin 1850 organizoi lojrat olimpike në Wenlock, lojra olimpike të rangut rajonal.



Baroni i ri

Shembulli grek

Në Olimp, në gadishullin e Peloponezitet para 2500 vjetësh kanë egzistuar lojrat olimpike. Lojrat e para u organizuan në vitin 776 (para Krishtit). Herakliti ishte iniciusi i këtyre lojrave. Thuhet se Herakliti, djali i Zeusit dhe Alkemenës, menjëherë pas lindjes ka ngordhur dy gjarpërinj helmues, te cilët i kishte dërguar gruaja xhelozë e Zeusit, Hera.

Pas shumë kohësh Hera ia arriti ta cmendte Heraklitin, saqë ai vrau dy fëmijët e vet. Si dënim për këtë veprim ai duhet ti shërbente mbretit Eurystheus, i cili i dha atij 12 detyra. Kështu Harakliti arriti të vrasë Luaniin e Nemeas, si dhe të fitojë përkundrejt Hydrës, gjarprit me 9 koka.

Më pas ai nis një duel me mbretin Augias, të cilin arrin ta vrasë. Pas kësaj Herakliti themeloi lojrat olimpike. Lojrat ishin të hapura për të gjithë grekët dhe i garantonin pjesëmarrësve dhe shikuesve mbrojtje dhe siguri gjate zhvillimit të tyre. Këto lojra arritën kulmin në shekullin e 4 dhe te 5 para Krishtit. Në vitin 393 pas Krishtit lojrat olimpike u ndaluan nga perandori Theodosius i cili i cilësoi ato një kult pagan.



Tablo e lojrave olimpike 1900 ne Paris



Dr. William Penny Brookes

1850

1900

1896

393 n.Chr.

776 v.Chr.



Tablo e lojrave të para olimpike 1896 në Athinë